

KLSH merr pjesë në takimin vjetor të Bordit Ndërkombëtar të Audituesve për NATO-n

Bordi Ndërkombëtar i Audituesve për NATO-n (The International Board of Auditors for NATO) zhvilloi më datë 07 qershor 2023, në Bruksel takimin me Trupat Kompetente Audituese Kombëtare (Competent National Audit Bodies) mbi aktivitetin e vitit 2022.

Bordi Ndërkombëtar i Audituesve për NATO-n (IBAN), në cilësinë e një trupe të pavarur të auditimit të jashtëm është përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare dhe auditimet e performancës së të gjitha subjekteve raportuese të NATO-s dhe shpenzimet e Programit të Sigurisë dhe Investimeve të NATO-s, si dhe për auditimet e pasqyrave financiare të Subjekteve shumëkombëshe ku NATO ka një interes të veçantë.

Aktiviteti i Bordit në vijimësi është bazuar në pavarësinë nga entitetet e audituara; integritetin për veprimtari të paanshme, objektive, të balancuar, jo politike, si dhe në profesionalizëm sipas kërkesave të parimeve dhe udhëzimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Znj. Daniela Morgante, në cilësinë e Kryetares së Bordit bëri prezantimin e Raportit të aktivitetit për vitin 2022, duke përcaktuar dhe objektivat për vitin në vazhdim. Në takim kishte diskutime, komente dhe sugjerime për çështje të ndryshme të raportit vjetor, në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të veprimtarisë audituese në të ardhmen.



Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të SAI-ve të ndryshme si Kanadaja, Finlanda, Belgjika, Spanja, Bulgaria, Çekia etj., si dhe u ndoq online nga një numër i konsiderueshëm i audituesve të jashtëm publik të shteteve të tjera. Kontrolli i Lartë i Shtetit, u përfaqësua në këtë aktivitet nga z. Gjovalin Preçi, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, si dhe z. Aldo Kume, Auditues në Departamentin e Institucioneve Qendrore.